

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT
KRYETARI

Nr. 1187 prot.

Tiranë, më 03.08 2022

URDHËR

Nr. 232, datë 03.08.2022

“Për pezullimin e procedurave të shortit gjatë periudhës së lejes vjetore”

Bazuar në nenin “C”, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 13, gërma “d” të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenin 18 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 7 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, si dhe në nenin 3 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit manual në Kolegjin e Posaçëm të Apelit”, për shkak të lejes vjetore të gjyqtarëve të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

URDHËROJ:

1. Pezullimin e procedurave të hedhjes së shortit për ankimet/kërkesat e regjistruara në kuadër të Juridiksionit të Rivlerësimit dhe në kuadër të Juridiksionit Disiplinor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit për periudhën 08.08.2022– 07.09.2022.
2. Drejtoria e Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun dhe Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbeshtetëse të marrë masat për protokollimin, verifikimin, pranimin dhe regjistrimin e ankimeve/kërkesave në regjistrat përkatës, në kuadër të Juridiksionit të Rivlerësimit dhe në kuadër të Juridiksionit Disiplinor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit për periudhën 08.08.2022– 07.09.2022.
3. Një kopje e këtij urdhri t’i komunikohet Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, Drejtorisë Ekonomike dhe të Shërbimeve Mbeshtetëse, si dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm me ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Klibana Shytilla

Bulevardi “Dëshmoret e Kombit” Nr. 3, Tiranë, www.kpa.al, e-mail: info@kpa.al

